



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1621/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Zlatno Zrno” me seli në rrugën Proleterski Brigadi 2/2 në Strgë të Maqedonisë së Veriu, kundër debitorit të përmbarimit “Broja Market” ShPK me seli në rrugën Mbretëresha Teutë p.n. në Mitrovicë, sipas dokumentit të besueshëm përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1648/22, të datës 29.09.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Zlatno Zrno” me seli në rrugën Proleterski Brigadi 2/2 në Strgë të Maqedonisë së Veri, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1648/22, të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1648/22, të datës 29.09.2023, në piken I të dispozitivit e ka aprovuar prapësimi i debitorit të përmbarimit “Broja Market” ShPK me seli në Mitrovicë, dhe e ka anuluar urdhri përmbarimor P.nr.121/2022 i datës 06.04.2022 i përmbaruesit privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbarimore në këtë çështje. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditori i përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit të përmbarimit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 312€, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të

aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1648/22 i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Ceshkje Ekonomike, ose lënda të kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Kreditori “Zlatno Zrno” me seli në Strugë të Maqedonisë së Veriut (këtu e tutje Kreditori) më 05.04.2022 ka parashtruar propozim për përmbartim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbartuesit privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbartimit “Broja Market” ShPK me seli në Mitrovicë (këtu e tutje Debitori) që t’ia paguaj shumën prej 21,000.00€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturën nr. 1/2019 të datës 28.02.2019 të tij për Debitorin, të cilin në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. faqja 2 nga 4 Përmbartuesi më 06.04.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.121/2022, me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Debitori më 22.04.2022 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbartimor. Ai ka pretenduar se fatura lëndore nuk i plotëson kushtet sipas LPP-së, meqë ajo nuk është pranuar nga Debitori. Gjithashtu ka deklaruar se detyrimi është parashkruar tashmë, pasi kanë kaluar mbi tre vite nga koha kur është lëshuar fatura. Përveç kësaj, ai ka pretenduar se detyrimin e ka përmbushur, gjegjësisht më 19.03.2019 e ka paguar shumën prej 19,700.00€ të faturës lëndore, ndërsa shumën prej 1300€ do ta paguante pasi Kreditori ta bënte servisimin, montimin dhe funksionalizimin e pajisjes së shitur. Për fund ka deklaruar se Kreditori nuk a ka përmbushur detyrimin e tij për servisim, montim dhe funksionalizim të aparatit të shitur, edhe pse me marrëveshje verbale e ka pasur për obligim. Prapësimin nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimin përmes avokati.

Kreditori në përgjigjen e tij në Prapësim ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar Prapësimi i Debitorit. Ai ka deklaruar se fatura lëndore është paguar pjesërisht në shumën prej 19,700.00€ dhe ka kërkuar që procedura të vazhdoj për vlerën e mbetur prej 1300€. Ka deklaruar se nuk e ka pasur për obligim ta bëj servisimin dhe se Debitorit nuk ka pasur asnjë vërejtje por vetëm ka kërkuar kohë për përmbushje të detyrimit. Ka shtuar se fatura lëndore i plotëson të gjitha kushtet për përmbartim. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e përgjigjes në prapësim përmes avokatit. Lidhur me prapësimin Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamenti i

Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.419/21, të datës 01.03.2022, në dispozitiv e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Mini Market Lirimi- A.A., të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat P.nr.553/2021 të dt. 05.02.2021 mbi caktimin e përmbarimit dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1648/22, të datës 29.09.2023, e ka aprovuar prapësimi i debitorit të përmbarimit “Broja Market” ShPK me seli në Mitrovicë, dhe e ka anuluar urdhri përmbarimor P.nr.121/2022 i datës 06.04.2022 i përmbaruesit privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbarimore në këtë çështje, duke vendosur me decedivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbarimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë , vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë të qëndrueshëm dhe të bazuara me ligj, sepse kemi të bëjmë parashkrim.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës është vërtetuar së në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim, sepse , sipas nenit 355 të LMD-së, përcaktohet se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”* ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*. Ndërsa sa i përket fillimit dhe ndërprerjes së parashkrimit, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se lidhur me këtë çështje është zbatuar drejt dispozitat e nenit 342 para. 1 i LMD-së, sipas të cilit *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*, si dhe neni 368 i LMD-së, i cili përcakton përcaktohet se *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa në para. 2 ka rregulluar se *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*.

Po ashtu, Kjo Gjykatë vlerëson se përmbartimi është kërkuar në bazë të faturës nr.1/2019 të datës 28.02.2018, e cila ishte paguar pjesërisht më 19.03.2019, ku përmes kësaj pagese ishte pranuar borxhi në formë të pagesës së pjesësisht të faturës lëndore, rrjedhimisht rrjedhja e afatit të parashkrimit sipas faturës lëndore ishte ndërprerë në datën e pagesës. Pasojat e ndërprerjes së rrjedhjes së parashkrimit të kërkesës rregullohen me neni 374 të LMD-së, i cili në par.1 përcakton se *“Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim”*, ndërsa në par. 2 theksohet se *“Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimiti (pohimi)”*. Sipas këtyre dispozitave, në rastin konkret parashkrimi i ndërprerë më 19.03.2019 përmes pranimit në formë të pagesës ka filluar të rrjedhë përsëri nga dita e pranimit, gjegjësisht nga datë 19.03.2019. Ku në anën tjetër, Debitori Propozimin e ka paraqitur më 05.04.2022, që nënkupton mbi tre (3) vite pasi ka filluar të rrjedhë afati i ri i parashkrimit për pjesën e mbetur të detyrimit në vlerë prej 1300€. Prandaj, Kjo Gjykatë nga shkresat e lëndës vërtetoje se debitori e ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër, i cili sipas LMD-së do ta kishte ndërprerë përsëri rrjedhjen e parashkrimit. Prandaj, rezulton se kërkesa e Kreditorit ndaj Debitorit është parashkuar.

Andaj, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës rezulton qarte se kreditori i ka lëshuar debitorit faturën 1/2019 të datës 28.02.2019, në bazë të cilës e ka filluar këtë procedurë përmbartimore, dhe po ashtu nuk ishte kontestuese ndërmjet palëve se debitori më 19.03.2019 e ka përmbushur pjesërisht detyrimin që rrjedh nga fatura, duke e paguar shumën prej 19,700.00€. Mirëpo, meqenëse këtë e ka deklaruar Debitori në Prapësim, ndërsa Kreditori e ka pohuar në përgjigjen e tij në prapësim, Kreditori e ka paraqitur Propozimin më 05.04.2022. Prandaj, duke u bazuar në kundërshtimin e debitorit se kërkesa e Kreditorit është parashkuar dhe duke pasur parasysh se të dy palët janë shoqëri tregtare, atëherë rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat lidhur me afatin e parashkrimit, përkatësisht dispozitën e nenit 355 par.1 të LMD-se.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se me nenin 71 par.1 1.10 i LPP-së, përcaktohet se *“ Prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*, Andaj, në këtë rast, Gjykata e shkallës së parë, me të drejt e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka përfunduar procedurën përmbartimore në këtë rast.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr. 1621/23, me datë 20.02.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi